



“ILLYRIAN GUARD” SH.A

Miratohet
ADMINISTRATORI
Robert LILI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, me _____.____.2022

PROCES VERBAL datë __.__.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Server”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Server – 48820000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,967,200 (Katër milion e nëntëqind e gjashtedhjetë e shtatë mijë e dyqind lek).

- Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021. **99,344** (Nentëdhjetë e nënte mijë e treqind e dyzet e katër) lek

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2,

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Në zbatim të urdhërit të prokurimit Nr. Prot 1332/44, Nr. 1726 datë 27.12.2022, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: “**Server**” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” sh.a ju informojmë për sa më poshtë:

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit të propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Vlera e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar nga data e publikimit duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën..*

2. Për kapacitetin teknik:

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese :

- Dëshmi të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare, me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet. Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i se njejtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e lidhur me institucionin të shoqëruar me vërtetimin e leshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshem të kësaj kontrate.

- Kur shërbimi i se njejtës natyre është realizuar me subjekte private, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e lidhur me subjektet private të shoqëruar me faturën/at tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik duhet te kete certifikimet ISO si me poshte:

- **ISO 9001, për menaxhimin e cilësisë**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Nisur nga proceset e punës dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës se tij, të bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë e kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

- **ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatori ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sigurinë e informacionit.

Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e të dhënave në mënyrën e duhur. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik përmbush standartet për sigurinë e informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqëse sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

- **ISO 20000-1, për menaxhimin e shërbimeve IT.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në menaxhimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit. Përmbushja e standartit ISO 20000-1 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve. Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këto ISO nga kompania ofruese për realizimin në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat e Illyrian Guard shpk. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të

Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh manaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të manaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standardit kompanitë aplikojnë praktikën më të mira, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

3. Operatori ekonomik për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të paraqesë të paktën 2 (dy) punonjës të cilët të kenë certifikimet e mëposhtme:

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në fushën e pajisjeve server.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në fushën e rrjetit kompjuterik.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalent, në fushën e pajisjeve server.

Argumentim: Për të siguruar instalimet dhe konfigurimet e nevojshme sipas kërkesave të kontratës është e domosdoshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e propozuar punonjës të certifikuar për instalim dhe konfigurim serverash.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në fushën e rrjetit kompjuterik.

Argumentim: Për të siguruar instalimet dhe konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues të pajisjeve të reja server objekt i kësaj kontrate, është e domosdoshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e propozuar punonjës të certifikuar për rrjetin kompjuterik. Konfigurimet e pajisjes server janë të domosdoshme për funksionalitetin dhe transmetimin e të dhënave nga serveri si dhe makinat virtuale që do të ndërtohen në këto server.

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm për zbatimin korrekt të kontratës, pasi për secilin nga pikat e projektit (Siguria e Informacionit, Pajisjet Server, Pajisjet rrjeti kompjuterik) duhen specialiste të trajnuar dhe certifikuar për zgjidhjen e problematikave dhe për sugjerime për përmirësime të mëtejshme dhe përshtatje të mundshme me teknologjitë e reja.

4.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë për çdo punonjës të certifikuar të përfshirë në projekt:

-Kontratë pune.

-Çertifikatat e mësipërme përkatëse të lëshuara nga ent certifikues i akredituar.

-Për punonjësin e certifikuar në fushën e pajisjeve server do të pranohet edhe certifikatë nga prodhues të pajisjeve server.”

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit,duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalog për mallin që oferton, të përkthyer në gjuhën shqipe, të markuar dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6.Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë janë të reja.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të përcaktojë se malli objekt prokurimi që do të ofertojë ka vite garanci perdorimi aq sa është e përcaktuar nga AK tek specifikimet teknike bashkelidhur.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë që do të marrë përsipër montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të përcaktojë se afate e levrimit trajnimit dhe testimit duhet të jenë sipas afateteve të përcaktuara nga AK.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sqarim:

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.